



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **Ekstrakt**

**nga procesverbali i mbajtur më 27 dhjetor 2019, në mbledhjen e XXVII (njëzeteshtatë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.**

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në objektin e ri të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përfshirë edhe anëtarin e ri z.Pajtim Hodolli, i cili bëri betimin, (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin Drejtorët e Drejtorive (DA; DKA; DPKGJ; DSHMS; DSHPMSH; DBPZHR, DI;) përfaqësuesja e OSBE-së znj.Shkendiza Killokoqi, përfaqësues të mjeteve të mediave dhe informimit, përfaqësues të GIS znj.Miral Hallaqi dhe z.Maliq Pireci, dhe disa prej zyrtarëve komunal.

### **Rendi i Ditës**

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, dhe duke i uruar punë të mbarë në sallën e re të Kuvendit të Komunës në objektin e ri të Komunës, si dhe duke i njoftuar rreth pikave të rendit të propozuar të ditës dhe rekomandimeve nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 20.11.2019, ndër të tjera shtoi, përshëndetje dhe falënderim shkon edhe për përfaqësuesit e organizatës GIS të cilët janë prezent këtu pas ftesës që iu kemi bërë sepse është një pikë e rendit të ditës e cila ndërlihet me këtë organizatë.

Besoj që thirrjen dhe materialet i keni marrë të gjithë me kohë, para se të fillojmë me punime dua t'ju njoftoj, edhe pse sigurisht jeni në dijeni që ish anëtari i Kuvendit të Komunës nga radhët e subjektit PDK z.Arbër Blaku para disa ditëve ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga pozita e këshilltarit të Kuvendit të Komunës për arsye siç thuhet personale dhe profesionale, kështu që unë si Kryesues i Kuvendit kam ndërmarrë gjitha procedurat dhe kam proceduar gjithë dokumentacionin dhe lëndën në KQZ për zëvendësimin e këshilltarit në fjalë. KQZ ka marrë vendim të cilin e kemi para vetës sipas të cilit është emëruar z.Pajtim Hodolli anëtar i Kuvendit të Komunës nga radhët e subjektit të njëjtë politik duke zëvendësuar ish këshilltarin z.Arbër Blaku, kështu që ftoj komisionin për verifikimin e mandateve të anëtarëve të Kuvendit (z.Avni Fetahu, znj.Doruntina Hasani dhe z.Fatmir Rudari) të kryej punën e vet në mënyrë që pastaj të bëhet betimi solemn nga ana e anëtarit të ri të emëruar që i njëjti të jetë anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës me të gjitha të drejtat e plota që i takojnë sipas ligjit.

**z.Avni Fetahu**, në emër të Komisionit për verifikimin e mandateve të Kuvendit, e paraqiti shkurtimisht raportin, si vijon, bazuar në vendimin e KQZ-së dhe dokumentacionin përcjellës, komisioni konstaton se dokumentacioni është rregull dhe janë përmbushur kushtet për dhënien e betimit solemn nga z.Pajtim Hodolli.

***Dhënia e Betimit nga z.Pajtim Hodolli i emëruar anëtar i Kuvendit të Komunës së Podujevës.***

**Kryesuesi i Kuvendit**, sqaron procedurën e dhënies së betimit dhe fton të përmendurin të ngritët në këmbë dhe të jap betimin solemn si anëtar/këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

*Me tekstin si në vijim,*

*“Unë, PAJTIM HODOLLI betohem se do t’i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”*

z.Pajtim Hodolli, u konstatua se nga tani e tutje është këshilltar i Kuvendit të Komunës së Podujevës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, për çka Kryesuesi i Kuvendit të Komunës i uron punë të mbarë dhe suksese

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, tani vazhdojmë me punë, urdhëroni nëse ndokush ka diçka rreth rendit të propozuar të ditës, nëse jo e hedh në votim sipas thirrjes dhe materialit përkatës, përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

*Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës dhe rekomandimeve nga KPF.*

## **1. Propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2020**

**z.Abaz Llugaliu**, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, para vetës keni për miratim propozim vendimin e Kryetarit të Komunës, për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2020, Listë e cila është propozuar për miratim duke u bazuar në nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, gjegjësisht në nenin 13 të ligjit parashihet që Komuna duhet të publikoj listën e veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin vijues më së largu deri më 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin e Komunës.

Lista e pronave për dhënie në shfrytëzim duhet të përmbaj këto të dhëna; -të dhëna kadastrale të pronës, -Qëllimin, -destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe –periudhën kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Sipas asaj që thuhet në paragrafin 2 të nenit 13 të Ligjit në fjalë, ne në Listë kemi paraparë secilën pronë veç e veç. Po ashtu edhe një sqarim rreth listës që ju është dërguar me materialin e mbledhjes, në mbledhjen e KPF-së është prezantuar dhe rekomanduar të zëvendësohet me një listë tjetër e cila është ri përgatitur vetëm teknikisht, në formë tabelare, por që përmbajtja është e njëjtë si dhe është më pak voluminoze dhe më e qartë në lexim, ashtu siç ju është përcjellë me rekomandimet e KPF-së për shqyrtim dhe miratim.

Andaj pas shqyrtimit dhe miratimit nga ana e Kuvendit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, lista si e tillë do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Komunës dhe në tabelat publike përkatëse në objektin e Komunës.

**z.Avni Fetahu**, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahë këtë Listë të pronave për dhënie në shfrytëzim dhe urojmë që krahas kësaj liste edhe më të sqaruar në modelin e dytë, urojmë që gjatë këtij viti ashtu siç e sqaroj edhe drejtori parafolës, lista të pasurohet edhe me një program të veçantë në mënyrë që qasja e investitorëve potencial por edhe qytetarëve të Komunës tonë t’iu jepet mundësi që në ato prona të shprehin gatishmëri për t’i marrë në shfrytëzim.

**z.Bajram Ajeti**, theksoi, përshëndeti të gjithë, me theks mërgimtarët e ardhur në Kosovë për festat e fund vitit, dhe duke uruar lokacionin/sallën e re të mbledhjeve të Kuvendit përkatësisht objektin e ri të Komunës, mirëpo dy çështje që vërejtja se janë risi, njëra është gabim që nuk e kemi Flamurin Kombëtar që e kishim në sallën e ish objektit të Komunës, dhe e dyta që tani asamblistët me drejtorët do të jenë ballë për ballë.

Çështja e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim është e rregulluar me ligj, kurse sot kemi një plan i cili ka të bashkëngjitur Listën e veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2020, të nënshkruar nga drejtori i DPKGJ, një tabelë në emër të Kryesuesit të Kuvendit të pa nënshkruar por me të njëjtat të dhëna dhe kuptohet edhe propozim vendimin e Kryetarit të Komunës por të nënshkruar nga Nënkryetari i Komunës që edhe ai sot nuk është prezent në këtë mbledhje dhe arsyeja që Kryetari nuk është sepse është në kryeqytet me ambicie e jo nga Komuna ku ka marrë përgjegjësi me betim, por nejtse.

Sipas nenit 5, paragrafi 1 nënparagrafët 1.1 deri në 1.4 të Ligjit nr.06/L-092 për dhënin në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, janë të përcaktuara edhe kriteret për dhënie në shfrytëzim të pronës, të cilat po i ceku; -prona duhet të jetë e regjistruar e që ky kusht besoj që është i plotësuar, -qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës të jetë i harmonizuar me dokumentet e planifikimit hapësinor, kriteri i cili besoj që nuk është i plotësuar sepse nuk kemi asnjë dokument i cili na bënë me dije një gjë të tillë, pastaj -duhet të ketë arsyeshmëri të interesit publik apo përfitimit ekonomik të Komunës e që në mënyrë të përgjithësuar edhe ky kriter është plotësuar, dhe kriteri tjetër është -të plotësoj kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore e që edhe për këtë kriter mendoj se nuk është plotësuar sepse nuk kemi kurrfarë arsyeshmërie të bashkëngjitur në dokumentin e dërguar. Pra e ceka se kriteri i parë është plotësuar, kriteri i dytë nuk ka dëshmi me dokumentacion se ka diçka lidhur me planifikimin hapësinor dhe mendoj se edhe kriteri i katërt po ashtu nuk është plotësuar lidhur me mjedisin.

Sipas nenit 6 paragrafi 1 nënparagrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit në fjalë, është përcaktuar edhe afati i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, përkatësisht afatshkurtër prej 1 deri në 15 vite dhe afatgjatë prej 15 deri në 99 vite, ndërsa në Listën e veçantë afatet janë caktuar vetëm me afatshkurtër dhe afatgjatë, andaj mendoj se është dashur të përcaktohet me afate precize, dhe atë sa, por jo në formën e paraqitur sepse lë dyshime se kujt po jepet nga komisioni vlerësues e që dyshimin e kemi ne si LVV sepse asnjëherë anëtari i komisionit nga radhët e LVV-së nuk është ftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt për mbledhjet e komisionit.

Nga 34 prona të Listës së veçantë, dua të veçoj pronat me nr. rendor 33 dhe 34, ajo me nr.33 ka sipërfaqe 2237 m<sup>2</sup> në të cilën ka lokale afariste, njëri me 50 m<sup>2</sup> dhe tjetri me 55 m<sup>2</sup>, shtrihet pyetja, çfarë statusi ka patur deri më tani kjo pronë, lokalet kur janë ndërtuar, a kanë leje ndërtimi, a është bërë kërkesa për legalizim etj. Kështu që kjo pronë pa u sqaruar të mos pranohet, të mos jepet në shfrytëzim apo të futet në planin pa u dhënë arsyetim i plotë, veçanërisht meqë është në zonën e qytetit dhe duhet të plotësohet domosdoshmërisht edhe kriteri dike patur dokumentin e planifikimit hapësinor dhe që është në pajtim me kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore e që e njëjta vlen

edhe për pronën me nr. rendor 34. Mendoj se në pajtim me nenin 8 të Ligjit të cekur, ka qenë dashur të jepet/paraqitet edhe procedura e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, a është ankand publik, a është shprehje e interesit apo është rezultat i negociatave të Kryetarit të Komunës e që e ka të drejtën sipas ligjit.

Dhe ajo që më bënë kureshtarë por edhe insistues është, pse Komuna nuk ka bërë dhe pse është kërkuar, madje jo njëherë publikimi i listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës kur për këtë e obligon neni 13 i Ligjit në fjalë siç e ceku, por pjesërisht drejtori i DPKGJ në fjalën hyrëse, nen i cili thot, Komuna duhet të publikon listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës si dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin vijues deri më 31 dhjetor, duke arsyetuar interesin publik dhe zhvillimin ekonomik të Komunës, andaj mendoj se obligim ka qenë që ne në këtë seancë ta kemi edhe listën e përgjithshme të pronave të Komunës meqë është çështje e cila po përcillet ndoshta qe 5-6 vite me radhë.

Krejt në fund, ligji obligon Kuvendin e Komunës të formoj komisionin e ankesave e që jam në dijeni se ky komision ekziston ngase aplikuesve duhet t'iu jepet edhe e drejta e ankesës. Pra duke patur parasysh se praktika e deritanishme e dhënies së pronave të paluajtshme në shfrytëzim e që jo në pak raste është keqpërdorë qoftë edhe nga shfrytëzuesi, mos mbikëqyrja e realizimit të qëllimit për dhënie dhe mos respektimi edhe i parimeve të përcaktuara me ligj, qoftë ai i ligjshmërisë, i efikasitetit, trajtimit të barabartë të palëve, pastaj ai që është tepër i rëndësishëm për një administratë komunale është parimi i transparencës e kështu me radhë, kështu që si Grup i këshilltarëve të kuvendit nga radhët e LVV-së ne do ta japim votën pro, por me kusht që ne do t'i përkushtohemi dhe ta përcjellim edhe gjithë procedimin deri në realizimin e kësaj Liste të veçantë për dhënie të pronave në shfrytëzim.

Për fund shfrytëzoj rastin që juve që jeni këtu dhe gjithë qytetarëve të Llapit t'ju uroj vitin e ri 2020 duke ju dëshiruar shëndet, fat dhe lumturi.

**z.Fatmir Rudari**, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit PDK e përkrahim propozim vendimin për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2020. Besojmë që pronat sipas listës në fjalë do t'i nënshtrohen procedurave ligjore përmes komisionit dhe gjithçka do të shkoj në rregull.

**z.Abaz Llugaliu**, drejtor i DPKGJ, theksoi, mora fjalën me qëllim të sqarimit për këshilltarin parafolës z.Bajram Ajeti. Paluajtshmëria e evidentuar në nr.33 të listës, gjinden lokalet afariste tek e ashtuquajtura “furra e Azem Cikajt” konkretisht në rr. “Skënderbeu” përballë shkollës “DR.Ibrahim Rugova” ku deri tani janë shfrytëzuar si teneqepunues nga dy persona të cilët kanë pasur borgje ku për njërin është ndërprerë kontrata kurse tjetri nuk ka hapur më fare lokalin. T'ju them të drejtën nuk e di a mund të quhen lokale ato apo duhet të rrenohen, mirëpo ekzistojnë si pronë komunale dhe kemi paraparë t'i japim në shfrytëzim meqë jemi të obliguar sepse në rast se një pronë nuk është paraparë në listë, atëherë nuk mund të jepet në shfrytëzim deri në vitin vijues, kështu që kemi paraparë një gjë të tillë tani në fund të vitit sepse kemi pritur nënshkrimin Rregullores përkatëse që përcakton procedurat, kushtet dhe kriteret e dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, prandaj ne kemi menduar që për të mos pasur bllokada në vitin që vie kemi propozuar këtë listë për miratim.

Po ashtu prona e cila parashihet në nr. rendor 34 të listës, kemi një lokal afarist prapa “Beni Dona” i cili po ashtu për shkak të borgjeve i është ndërprerë kontrata dhe ka mbet lokal i lirë.

Sa i përket publikimit të listës së përgjithshme ashtu siç parashihet në nenin 13 të ligjit, edhe unë jam dakord, mirëpo listë zyrtare të pronave të paluajtshme në mbarë territorin e Komunës qoftë pronave private qoftë komunale, është regjistri i pronave të paluajtshme apo kadastri zyrtar nga i cili ne kemi nxjerrë një listë të pronave ku janë rreth 2435 në 78 zona kadastrale të Komunës së Podujevës.

Disa Komuna kanë nxjerrë një listë të përgjithshme por me kompani të ndryshme tenderuese, mirëpo ne besojmë se pasi që në vitet e fundit me akte nënligjore për kadastrë dhe gjeodezi janë hequr prej zyrës kadastrale matjet në sektorin privat, por besoj që me ekipet tona të gjeodetëve shpejt do të përgatitim listën e përgjithshme të pronave komunale, edhe pse nuk jemi të obliguar që listën e përgjithshme të pronave ta paraqesim për miratim në Kuvend.

**z.Bajram Ajeti**, theksoi, kjo që u tha nga parafolësi se nuk jemi të obliguar për listën e përgjithshme, mendoj se është deklarim i nxituar sepse unë e citova edhe nenin i cili obligon një gjë të tillë ku thuhet, Komuna duhet të publikoj listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të Komunës, si dhe listën e veçantë, prandaj kjo është obligim ligjor dhe nuk mund të liroheni nga përgjegjësia ngase sa më shpejt duhet të publikohet lista e përgjithshme e pronave publike. Pastaj jeni në dijeni që disa herë, madje edhe në mandatin e kaluar por edhe në këtë mandat disa herë kemi kërkuar që të bëhet publike një listë e tillë.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, sa po vërej nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, andaj e vë në votim këtë propozim vendim për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2020, sipas materialit përkatës dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozim vendimi për miratimin e Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2020, sipas materialit përkatës dhe konstatimeve të rekomanduara nga mbledhja e KPF-së.*

## **2. Propozim Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019–2021**

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit prezent këtu kemi edhe përfaqësuesit e organizatës GIZ të cilët kanë qenë pjesëmarrës në hartimin e këtij plani bashkërisht me grupin punues përkatës, andaj nëse ndokush ka kërkesa për ndonjë sqarim, përgjigje apo çështje të ndryshme, besoj që janë të gatshëm të marrën fjalën, gjithnjë me pajtimin e Kuvendit, mirëpo do të ishte mirë që fillimisht fjalën hyrëse ta jap drejtori i Drejtorisë përkatëse.

**z.Faik Muçiqi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse lidhur me propozim planin në fjalë, ndër të tjera theksoi, fillimisht falënderoj GIZ-in për përkrahje që ka dhënë grupit punues për hartimin e këtij propozimi plani, si dhe përkrahjen e dhënë për hartimin e dy Rregulloreve komunale të miratuara nga ky Kuvend (Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave dhe Rregulloren për mbrojtjen e ambientit) si dhe që bashkërisht me këtë organizatë jemi duke hartuar planin e mobilitetit i cili pritet që shumë shpejt të sjellët në Kuvend.

Meqë drafti i këtij plani ju është dërguar me kohë dhe i cili ka kaluar gjitha procedurat dhe që keni pasur kohë të mjaftueshme ta shfletoni dhe ta analizoni, andaj këtu i prezent janë dy zyrtar të organizatës së cekur të cilët janë të gatshëm të japin sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme varësisht kërkesave të këshilltarëve të Kuvendit.

Ky plan është si pilot projekt i krijimit të sistemit të menaxhimit të energjisë, dhe Komuna e Podujevës ka qenë përfituese e këtij projekti, objektivat e të cilit kanë qenë, zvogëlimi i konsumit të energjisë në sektorët e ndërtimit të ndërtesave, transportit dhe ndriçimit publik, pastaj reduktimi i koston së energjisë në buxhetin komunal, përmirësimi i shërbimeve komunale, renovimet e

ndërtesave dhe instalimeve, zvogëlimi i energjisë, zvogëlimi i CO2 e të tjera. Përfitimet e pritura nga ky plan i cili nëse miratohet do të filloj të implementohet në vitin e ardhshëm për të cilin krahas buxhetit komunal do të kemi edhe buxhet edhe nga donatorët që shpresoj se do të ketë, janë të natyrës mjedisore operacionale.

Në këtë dokument ka shumë tabela me të dhëna të marra nga zyrtarët komunal sipas gjendjes reale në të gjithë sektorët, qoftë në arsim, shëndetësi, administratës, kulturës, gjitha ndërtesat publike, gjitha shkollat dhe të tjera janë evidentuar me gjendjen e tyre reale qoftë në mure, dritare, dyer, ngrohjet e të tjera të ngjashme që hyjnë në fushën e eficiencës së energjisë, pastaj tek ndriçimi publik është paraqitur gjendja në tërësi dhe në detaje e tanishme duke u saktësuar edhe me numrin e tyre ku edhe keni mund të shihni se ende kemi llampa të natritumit por që të cilat jemi duke i zëvendësuar dhe vetëm në këtë vit krahas ndriçimit që është bërë 13 km gjatësi, siç jeni në dijeni se vetëm në ti segmente, rruga për Peran, rruga për Shtedim dhe rruga për Orllan me rreth 7.8 km dhe me afër 300 trupa ndriçues të sistemit Led. Buxheti në këtë vit për këtë sektor është afër 180,000.00€ për investime kapitale dhe të shërbimeve. Po ashtu janë evidentuar edhe gjendjet e të gjitha objekteve publike të cilat do t'i përmirësojmë.

Për fund, duke ju falënderuar paraprakisht për kontributin që do të jepni në vazhdim, kërkoj që ta miratoni këtë plan në mënyrë që nga viti i ardhshëm të fillojmë me zbatimin e tij sipas sugjerimeve të këtij dokumenti duke shpresuar që kontributi i Komunës të jetë krahas mundësive buxhetore dhe mundësive tjera që krijon Komuna dhe Qeveria sa i përket sektorit të eficiencës së energjisë.

**z.Avni Fetahu**, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit LDK, e përkrah këtë propozim plan të veprimit për eficiencë të energjisë duke uruar që ky plan të jetësohet me buxhet.

Jemi të vetëdijshëm se Komuna e Podujevës ka pasur dokumente të tilla të kësaj natyre të cilat për fat të mirë janë mbështetë me buxhet nga Komuna e Podujevës, e që urojmë që në vitin e ardhshëm të rritet ky buxhet. Në përgjithësi dokumentet të cilat kanë të bëjnë me eficiencë, ashtu siç e kam potencuar edhe në mbledhjen e KPF-së, duhet të jetësohen edhe brenda objekteve, jo vetëm në ambientet e jashtme, edhe pse kjo ka ndodh e që është për tu përhëndetur.

Në të njëjtën kohë kërkojmë dhe mendojmë se është shumë jetike që ky plan të jetësohet me buxhet dhe mbi të gjitha me një qëndrueshmëri më të gjatë.

Jemi të vetëdijshëm se kompanitë konkurrojnë me çmime jashtëzakonisht të ulta dhe mund të ndodh të bëhet një ndriçim me një afat të qëndrueshmërisë, ta zëmë 2 vite, prandaj duhet të kërkohet që fati i qëndrueshmërisë të jetë të paktën 10 vite.

**z.Lirika Maliqi**, theksoi, fillimisht falënderojmë organizatat, e që në këtë rast është GIZ që po na mbështetin në përmirësimin dhe avancimin e politikave përmes të cilave të paktën përfitojnë qytetarët e Komunës tonë.

Eficienca e energjisë është një prej politikave më të thjeshta ose elementare në kuadër të mbrojtjes së ambientit e që ndryshe njihet si një prej politikave të gjelbërta, një trend botëror dhe jetik për të tashmen dhe të ardhmen e njerëzimit. Pa tjetër që edhe ne si Komunë megjithatë si shtet duhet të bëjmë pjesën tonë në mbrojtjen e të ardhmes tonë të përbashkët. Eficienca e energjisë është multidimensionale sepse nuk ka të bëjë vetëm me poqët elektrike apo me mënyrën se si ne i ndriçojmë objektet dhe hapësirat publike, por ka të bëjë edhe me mënyrën e ndërtimit të objekteve, mënyrën se si i ngrohim objektet publike e deri te gjetja e alternativave për përfitimin autonom të energjisë së ripërtëritshme elektrike, shembull, panele diellore, turbinat me erëra apo deri te modelet më të avancuara të teknologjisë moderne të energjisë së ripërtëritshme dhe të pastër.

Sugjerimet tona janë që të kemi kujdes në poqa eficient, pra të mos kemi dublikim të investimeve apo thënë më sakt të mos kemi investime në të njëjtin vend dhe me të njëjtat arsyeje.

Ne e mbështesim planin komunal të veprimit për eficiencë të energjisë elektrike si parakusht i domosdoshëm për një shoqëri moderne, kursim të energjisë dhe parasë publike dhe mbi të gjitha mbrojtje të ambientit, duke uruar që ky plan të realizohet me sukses dhe po shpresojmë që një ditë, edhe pse ka pak gjasa të ndodh, të shohim një plan komunal të eficiencës për shpenzime për dreka, darka dhe të karburantit për qeverinë komunale.

**z.Rafet Llapashtica**, theksoi, meqë është seanca e fundit për këtë vit, shfrytëzoj rastin t’ju uroj festat e fund vitit gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe mbarë Kombit, duke uruar që vitit 2020 të jetë një vit i mbarë dhe i shëndetshëm për të gjithë.

Një përshëndetje të veçantë kam për përfaqësuesit e GIZ për përkrahje të jashtëzakonshme në hartimin e planit komunal të veprimit për eficiencë të energjisë, plan i cili sigurisht që do të jap rezultate në Komunën e Podujevës, në bazë të njoftimeve që bëri drejtori i DSHPMSH në mbledhjen e KPF-së por edhe sot. Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit PDK e mbështet këtë propozim plan dhe mendojmë se është plan, për të mos e quajtur jetik, por shumë i nevojshme i cili do të jap rezultatet e veta duke i dhënë shtytje të gjithë të bashkuar në forma tona që ky plan të realizohet në vitet pasuese. Nuk dëshiroj të lëshohem rreth rëndësisë së eficiencës apo formave të energjisë qoftë solare qoftë formave tjera që krijojnë mundësi dhe kushte më të shëndetshme dhe më të mira për jetën duke iu shmangur vetëm formës së thëngjillit qoftë për ngrohje apo për ndriçim, kështu që grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e mbështet këtë plan dhe kërkojmë që si i tillë të funksionalizohet me mundësitë më të mëdha të mundshme.

Në mbledhjen e KPF-së, pas diskutimeve i kemi rekomanduar Kuvendit që para miratimit të këtij dokumenti të bëhet zëvendësimi i zyrtarit komunal z.Rasim Fejza për arsye se ne sot do ta miratojmë këtë dokument, por nuk jam në dijeni se a e kanë marrë vendimin personat kompetent që të bëhet zëvendësimi i zyrtarit të cekur për arsye se ai kryen një detyrë tjetër, andaj para votimit është mirë t’i kryejmë të gjitha detyrat që na takojnë.

Për arsye morale dëshiroj të ngriti edhe një njoftim, e që ndoshta do të ishte mirë të bëhej edhe qysh në fillim, fjala është se ne jemi të njoftuar që këshilltari i Kuvendit të Komunës së Podujevës nga radhët e subjektit politik LDK z.Bunjamin Hoti, në bazë të njoftimit të Agjencionit Kundër Korrupsion - AKK, i cili besoj që ka marrë edhe ai njoftimin, se është në konflikt të interesit për arsye se bartë detyrën e kryerjes së funksionit të kryetarit të OJQ-së Lidhja Rinore Blue dhe njëkohësisht mbanë mandatin e këshilltarit të Kuvendit, i cili jep votë në Kuvend, prandaj para vënies në votim të të këtij plani i përmenduri të deklarohet se a ka dhënë dorëheqje prej drejtimit të OJQ-së së përmendur sipas asaj që AKK ka thënë me njoftim, e them këtë për arsye se sa jam në dijeni zyrtarisht tek ju i nderuari Kryesues i Kuvendit nuk ka paraqitur dorëheqjen. Nëse nuk është zgjidh kjo çështje, kërkoj të përsëritet votimi edhe i rendit të propozuar i ditës edhe votimi i pikës paraprake si dhe këshilltari i cekur të mos merr pjesë në votim as për pikat tjera si këshilltar me konflikt interesi.

**z.Bunjamin Hoti**, theksoi, meqë këshilltari parafolës e ngriti këtë çështje, dëshiroj t’ju informoj se është e vërtetë se AKK ka iniciuar një rast të tillë që këshilltari z.Rafet Llapashtica e përmendi, mirëpo janë bërë të gjitha plotësim ndryshimet e nevojshme që janë kërkuar dhe rasti është mbyllur, madje këtu me vete e kam edhe vendimin përkatës por që nuk e besoj që është e nevojshme t’ia dorëzoj ndokujt prej kolegëve.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, falënderoj këshilltarin parafolës për këtë sqarim të dhënë, dhe besoj se mund të vazhdojmë me punë me pikën e rendit të ditës, urdhëroni, nëse jo atëherë nëse pajtoheni, e që besoj se po, fjalën ja jap përfaqësuesit të organizatës GIZ të jap një fjalë rasti rreth planit në fjalë.

**z.Maliq Pireci**, përfaqësues i organizatës GIZ, përshëndeti të pranishmit, theksoi, në emër të projektit të quajtur “*Projekti i Kosovës për Eficiencë të Energjisë*”, dhe koleges time që është këtu prezentë Miral Hallaqi – Radoniqi, dëshiroj të falënderoj Komunën e Podujevës për bashkëpunimin e mirë që kemi pasur në implementimin e këtij projekti i cili ka qenë paksa kompleks për shkak se dokumentin që ju keni parë është final, mirëpo për të ardhur deri te ky dokument final është dashtë punë shumë e madhe me mbledhjen e të dhënave në terren për secilën ndërtesë dhe ndriçimin publik si dhe vendosjen e tyre në databaz dhe bërjen në një.

Komuna e Podujevës është një prej Komunave pilote që ka përdorur këtë softwer dhe që mandej ka gjeneruar llogaritjet e të dhënave që pastaj janë vendosur në plan. Kjo ka qenë një punë shumë e madhe, punë kolosale ku gjithashtu për këtë ka bërë punë shumë të mirë edhe grupi punues prej 13 zyrtarëve komunal të caktuar prej Kryetarit të Komunës si dhe të dy praktikantëve të cilët janë mbështetur nga projekti nëpërmes Asociacionit të Komunave të Kosovës. Gjithashtu ka qenë një bashkëpunim i mirë me DSHPMSH për shkak se kjo Drejtori ashtu sikurse në shumicën e Komunave të Kosovës mbulojnë pjesën e eficiencës së energjisë elektrike dhe kanë të gjitha kapacitetet e nevojshme.

Po ashtu Komuna e Podujevës ka qenë njëra prej komunave që edhe më parë ka pas projekte për eficiencë të energjisë, por obligimet e reja që po rrjedhin kanë kërkesa më të mëdha por edhe kompetencat e Komunës janë më të mëdha andaj edhe ne jemi në përpjekje të vazhdueshme për themelimin e zyrave komunale për eficiencë energjetike dhe pastaj edhe ndërlidhjen e tyre me monitorimin e implementimit të projekteve të cilat janë të parapara në plane dhe raportimin e tyre në Agjencinë e Kosovës për Eficiencë, e që ndërlidhet shumë me përfitimet komunale për shkak se ku bëhet monitorimi dhe raportimi vërtetë vlerësohet si po shkon investimi dhe cila është dobia reale e investimeve, por kjo çështje gjithnjë është edhe në përputhje me politikat evropiane që Kosova si shtet i ka. Për fund, duke falënderuar edhe përfaqësuesit e subjekteve politike të cilët paraprakisht në deklaratimet e tyre i japën mbështetje këtij plani, shfrytëzoj rastin t’ju uroj të gjithëve për objektin e ri të Komunës dhe festat e fund vitit.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, edhe njëherë falënderoj parafolësin dhe organizatën GIZ në përgjithësi për mbështetje të vazhdueshme Komunës së Podujevës, me theks për hartimin këtij plani meqë kemi në rend dite dhe jemi duke e shqyrtuar, duke uruar që bashkëpunimi të vazhdojë edhe në fusha tjera varësisht nevojave dhe kapaciteteve.

Me nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, konsideroj se diskutimet rreth kësaj pike përfunduan, andaj e vë në votim propozimin Planin Komunal të Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021, me plotësim ndryshimet e rekomanduara me konstatimet nga mbledhja e KPF-së.

*Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozimi Planin Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (PKVEE) 2019-2021, sipas materialit përkatës të dërguar duke përfshirë edhe plotësim ndryshimet e rekomanduara me konstatimet nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 26.12.2019, me rekomandim që brenda një afati të shkurtër të bëhet spastrimi i tekstit dhe korrigjimet përkatëse të planit.*



**3. Propozimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës për zëvendësimin e z.Naim Bajraktarit me z.Besfort Kruma, i nominuar për anëtarë në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB, Podujevë**

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, kemi këtë pikë të rendit të ditës e cila ka hyrë pikë shtesë nga mbledhja e KPF-së e që ka të bëjë me zëvendësimin e anëtarit/përfaqësuesit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi – Podujevë.

**z.Faik Muçiqi**, drejtor i DSHPMSH, dhe njëkohësisht edhe koordinator i KKSB-së-Podujevë, theksoi, ju njoftoj se me njoftimin/urdrin e Komandantit të Forcës së Sigurisë së Kosovës tani e tutje është caktuar z.Besfor Kruma i cili do ta përfaqësoj FSK-në në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi të Podujevës, duke zëvendësuar ish përfaqësuesin z.Naim Bajraktari të cilin njëkohësisht e falënderojmë për bashkëpunimin e deritanishëm. Sipas njoftimit që kemi deri te ky ndryshim është ardh për shkak riorganizimit brenda për brenda FSK-së.

**z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit**, theksoi, lidhur me këtë çështje besoj që u sqaruam mirë andaj konsideroj se do të merr miratimin nga ana e Kuvendit të Komunës, por meqë procedurat parashohin ashtu, unë do të vë në votim që me vendim të bëhet zëvendësimi i përfaqësuesit të FSK-së ashtu sipas asaj që e paraqiti parafolësi drejtori i DSHPMSH, nga cilësia e koordinatorit të KKSB.

*Pas votimi Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri, me vendim miratohet propozimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës për zëvendësimin e z.Naim Bajraktarit me z.Besfort Kruma, i nominuar për anëtarë në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB - Podujevë.*

**4. Të ndryshme**

**znj.Doruntana Hasani**, theksoi, meqë stafi po thuhet është bartur në tërësi në këtë objekt të ri të Komunës, dhe në bazë të saj që unë vazhdimisht kam kërkuar zgjidhje për bibliotekën, e që tani veç po bëhen rreth 1 vit e gjysmë që Podujeva nuk ka bibliotekë, kërkoj nga ju që sa më shpejt të jetë e mundur të bëhet zgjidhje për bibliotekën, kjo ngase vazhdimisht arsyetimi i juaj ka qenë objekti i Komunës, por që duke qenë në dijeni se keni pasur edhe objekte tjera komunale që keni mundur t'i shfrytëzoni, mirëpo besoj që tani nuk ka më arsye që biblioteka të mos ketë zgjidhje. Për fund shfrytëzoj rastin t'juaj uroj vitin e ri 2020 duke ju dëshiruar të gjitha të mirat.

*Kryesues i Kuvendit, meqë nuk pati të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje duke theksuar,*

*Në emër të Kuvendit të Komunës së Podujevës dhe në emrin tim personal uroj qytetarët e Komunës së Podujevës dhe republikës së Kosovës në përgjithësi, vitin e ri 2020 duke ju dëshiruar shëndete, fat, lumturi dhe suksese në të gjitha sferat e jetës.*

**Mbledhja përfundoi në ora 11:00**

**Procesverbalin e mbajti**

**Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0096135/19**

**Podujevë,**

**27 dhjetor 2019**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Fatmir Gashi**